



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 25, datë 23.05.2016

**Për**

**“MIRATIMIN NË PARIM TË ZGJIDHJES SË KONTRATAVE TË QIRASË TË LIDHURA  
ME SHOQËRINË “MAK ALBANIA” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, pika 1/1.2, shkronjat “a” dhe “c” e pika 1/1.6, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 55, nenit 65, pika 1 dhe nenit 66, shkronja “c” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 659 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 30.05.2013 për “Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pezë, të qarkut të Tiranës (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 për “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; kërkesës me nr. prot 10730, datë 11.08.2015 së shoqërisë “Mak Albania” sh.p.k. “Për përfundimin e kontratave të qirasë” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin në parim të zgjidhjes së kontratave të qirasë të lidhura midis Këshillit të Rrethit, Tiranë dhe shoqërisë “Mak Albania” sh.p.k. si më poshtë vijon:
  - Kontrata e qirasë datë 10.02.1994, për pronën nr. 24/18 A, zona kadastrale nr. 2953, me sipërfaqe 15.000 m<sup>2</sup>, (Njësia Administrative Pezë);
  - Kontrata e qirasë datë 11.11.1994, për pronën nr. 24/18 B, zona kadastrale nr. 2953, me sipërfaqe 5.000 m<sup>2</sup>, (Njësia Administrative Pezë);
  - Kontrata e qirasë datë 12.04.1995, për pronën nr. 24/18 C, zona kadastrale nr. 2953, me sipërfaqe 5.000 m<sup>2</sup>, (Njësia Administrative Pezë).
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësia Administrative Pezë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**